



DOKUMENT POLITIKASH

E drejta për të qëndruar nga perspektiva e të rinjve ruralë në Shqipëri

Bazuar në një konsultim me rreth 100 të rinj nga zonat rurale të Shqipërisë



Autorësia e fotografisë: Julvin Marku

Përgatitur nga:
Alba Tema, Koordinatore Kombëtare, Qendra e Rinisë Rurale

Hyrje

Në të gjithë Evropën, e drejta për të qëndruar në komunitetet rurale është tashmë një temë shumë aktuale diskutimi kur bëhet fjalë për adresimin e shpopullimit të zonave rurale. Strategjia e Bashkimit Evropian (BE) për të Drejtën për të Qëndruar, e publikuar zyrtarisht në maj 2026 nga Komisioni Evropian, përfaqëson një angazhim të fortë politik për të siguruar që të gjithë qytetarët evropianë të qëndrojnë dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre në vendin që e quajnë “shtëpi”.¹

Krahas saj, Strategjia e BE për Ripërtëritjen e Brezave në Bujqësi, e miratuar në tetor 2025, vendos një synim ambicioz: dyfishimin e përqindjes së fermerëve të rinj në BE deri në 2040, nga 12% në 24%.² Ajo shkon përtej vetëm bujqësisë, duke njohur që ripërtëritja e brezave në bujqësi varet nga ekzistenca e komuniteteve rurale të gjalla dhe nga përfshirja e njëmendtë e të rinjve në vendimet që merren për territorin e tyre. Kjo strategji prezanton një Paketë Fillestare për Fermerët e Rinj, promovon instrumente kreditimi pa interes, rrjetin e Ambasadorëve të të Rinjve nga Zonat Rurale dhe i kërkon çdo shteti anëtar të përgatisë një plan kombëtar për ripërtëritjen e brezave në bujqësi si pjesë e programimit të tyre pas vitit 2027.

Shqipëria nuk është ende pjesë e BE, por si vend kandidat ajo është e angazhuar në harmonizimin me kuadrin evropian të politikave të zhvillimit rural dhe ndjekjen e vlerave evropiane. Megjithatë, koncepti dhe parimet themelore mbi të cilat bazohet e drejta për të qëndruar në komunitetet rurale mungojnë nga diskursi i politikave kombëtare. Aktualisht, nuk ekziston asnjë kuadër kombëtar që adreson largimin e të rinjve nga zonat rurale dhe asnjë mekanizëm sistematik për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse në lidhje me të ardhmen e tyre.

Nevojat dhe prioritetet e të rinjve nga zonat rurale janë lënë historikisht pas dore në politikat kombëtare dedikuar të rinjve. Strategjia Kombëtare e Rinisë për periudhën 2022-2029³ përshkruan një kuadër të gjerë për përfshirjen e të rinjve, duke u fokusuar te punësimi, arsimi dhe pjesëmarrja në vendimmarrje. Megjithatë, ajo nuk i trajton nevojat specifike të të rinjve nga zonat rurale. Strategjia i përmend të rinjtë nga zonat rurale vetëm kur i referohet Strategjisë së Rinisë së Bashkimit Evropian (2019-2027), por nuk përfshin asnjë masë që adreson nevojat specifike të të rinjve rural. Përkundrazi, Strategjia e Rinisë e BE-së ia kushton qëllimin e saj të gjashtë të rinjve nga zonat rurale,⁴ duke synuar të krijojë kushte që të rinjtë rural të realizojnë potencialin e tyre, duke përmirësuar infrastrukturën, duke ofruar vende pune cilësore dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve rural në vendimmarrje. Pavarësisht kësaj, në Strategjinë Kombëtare të Rinisë në Shqipëri mungojnë masa konkrete që synojnë fuqizimin e të rinjve rural.

¹Komisioni Evropian. (2026). Komisioni Evropian prezanton strategjinë historike “E drejta për të qëndruar”. ec.europa.eu/regional_policy/whats-new/newsroom/05-05-2026-european-commission-launches-landmark-right-to-stay-strategy_en

²Komisioni Evropian. (2025). Strategjia për ripërtëritjen e brezave në bujqësi (COM(2025) 872 final). agriculture.ec.europa.eu/overview-vision-agriculture-food/generational-renewal_en

³Ministria për Rininë dhe Fëmijët. (2023). Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029. riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/SKR29_Anglisht.pdf

⁴Këshilli Evropian. (2018). Rezoluta mbi një kuadër për bashkëpunimin evropian në fushën e rinisë: Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019-2027 (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, C 456). eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:C:2018:456:TOC

Në anën tjetër, Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin për periudhën 2021-2027⁵ thekson rëndësinë e mbështetjes së fermerëve të rinj. Megjithatë, ndërkohë që ka propozuar disa masa që synojnë të rinjtë në zonat rurale, këto përpjekje kanë qenë të pamjaftueshme. Plani i veprimit i SARDF rekomandoi një nismë të re për fermerët e rinj brenda buxhetit kombëtar, e parashikuar për zbatim në 2022-2023. Megjithatë, kjo skemë është miratuar vetëm në vitin 2026⁶. Përkundrazi, Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së ka prezantuar instrumente si Mbështetja Plotësuese e të Ardhurave për Fermerët e Rinj (CISYF)⁷ dhe mekanizma të tjerë mbështetës për të inkurajuar fermerët e rinj të investojnë në zonat rurale.

Gjetjet kryesore nga konsultimi me të rinjtë

Mes janarit dhe shkurtit 2026, si pjesë e planifikimeve për Asamblenë e 2-të të të Rinjve nga Zonat Rurale, në kuadër të Parlamentit IV Rural Shqiptar, u zhvillua një konsultim i hapur me të rinj nga zonat rurale të Shqipërisë. Gjithsej rreth 100 të rinj të moshës 18 deri në 40 vjeç nga e gjithë Shqipëria plotësuan pyetësin. Pjesëmarrësve iu kërkuar të reflektonin mbi sfidat kryesore me të cilat përballen, çfarë mungon për t'i kthyer idetë e tyre në veprim dhe rekomandime për fuqizimin e të rinjve nga zonat rurale.

Një nga gjetjet më të domethënësë që rrjedh nga ky konsultim është hendeku mes dëshirës për të qëndruar dhe nevojës për t'u larguar nga komunitetet rurale. Emigrimi nga zonat rurale të Shqipërisë nuk është një zgjedhje e parë, por është një përgjigje ndaj dështimit të vazhdueshëm të instrumenteve të politikave për të krijuar kushte në të cilat të qëndruarit është një alternativë.

“Ne nuk duam bamirësi, duam mundësi të barabarta. Ndryshimi nuk vjen duke u thënë njerëzve të qëndrojnë në fshat, por duke e bërë fshatin një vend ku njerëzit duan të jetojnë.”

Në përgjigjet e të anketuarve nga të gjitha zonat përcillet një urgjencë, ku disa e përshkruan dekadën aktuale si dritaren e fundit të mundësisë për të ndaluar shpopullimin, para se komunitetet rurale të arrijnë në një pikë të pakthyeshme.

“Vlerësoni punën e këtyre njerëzve, që me duar të lodhura dhe me atë pak energji që u mbetet, përpiqen ende të mbijetojnë dhe të shpëtojnë qindra komunitete në të gjithë Shqipërinë. Zonat rurale duhet të marrin frymë 24 orë në ditë, 365 ditë në vit, jo vetëm për disa muaj në verë apo dimër.”

Konsultimi me të rinjtë identifikoi pesë grupe sfidash të ndërlidhura, të cilat të rinjtë nga zonat rurale i ngritën vazhdimisht në të gjitha rajonet dhe grupmoshat.

1

Mungesa e infrastrukturës rrugore, transportit publik, arsimit cilësor, kujdesit shëndetësor dhe aksesit në internet ishin ndër sfidat më të përmendura në

⁵Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2021). Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027. leap.unep.org/en/countries/al/national-legislation/strategy-agriculture-rural-development-and-fisheries-2021-2027

⁶Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2026). Skema Kombëtare 2026: 5.2 miliardë lekë mbështetje për bujqësinë, drejt përafrimit me standardet e BE-së. bujqesia.gov.al/skema-kombetare-2026-5-2-miliarde-leke-mbeshtetje-per-bujqesine-drejt-perafrimit-me-standardet-e-be-se/

⁷Komisioni Evropian. (n.d.). Fermerët e rinj: Mbështetja e të ardhurave në kuadër të Politikës së Përbashkët Bujqësore, Mbështetja Plotësuese e të Ardhurave për Fermerët e Rinj (CISYF). agriculture.ec.europa.eu/common-agricultural-policy/income-support/young-farmers_en

konsultim. Shumë prej të rinjve e përshkruan këtë jo si çështje komoditeti, por si çështje të drejtash themelore.

Infrastruktura rrugore ishte ankesa më konkrete, pasi fshatrat mbeten të paarritshëm nga rrugë të asfaltuara, veçanërisht në dimër, duke i shkëputur të rinjtë nga shkollat, vendet e punës, spitalet dhe tregjet. Disa të rinj përshkruan komunitete rurale ku ambulancat nuk mund të arrijnë në shtëpi dhe ku fëmijët ecin me orë të tëra për të arritur stacionin më të afërt të autobusit. Transporti publik, aty ku ekziston, është i rrallë dhe i pasigurt, duke e bërë lëvizjen e përditshme drejt punës apo universiteteve në qytetet fqinje praktikisht të pamundur për shumë të rinj.

"Jemi ende në një situatë ku fshatrat nuk kanë rrugë. Mungesa e kushteve bazë të jetesës po i shtyn të rinjtë jashtë vendit."

Infrastruktura arsimore është çështje urgjente, duke filluar nga ekzistenca e klasave kolektive, mungesa e shkollave profesionale, bibliotekave dhe arsimit të mesëm cilësor. E njëjta gjë vlen dhe për shërbimet shëndetësore ku qendrat shëndetësore funksionale janë të pakta, shpesh pa staf ose të hapura vetëm me kohë të pjesshme. Aksesin në internet, që gjithnjë e më shumë është parakusht për punën në distancë, mësimin online dhe aksesin në informacion, u përshkrua si i paqëndrueshëm, sidomos në fshatrat më të largëta, duke thelluar hendekun dixhital mes të rinjve rural dhe atyre urban.

"Shërbimet bazë nuk janë luks urban."

2

Mbështetja e pamjaftueshme financiare dhe besimi i kufizuar në proceset transparente të financimit është një sfidë tjetër me të cilën përballen të rinjtë nga zonat rurale në Shqipëri. Pothuajse një në pesë të anketuar theksoi drejtpërdrejt mungesën e financimit si një pengesë për të investuar në zonat rurale. Megjithatë, kjo sfidë shkon përtej mungesës së parave, tek mungesa e besimit mes të rinjve dhe institucioneve që duhet t'i mbështesin ata.

Të rinjtë i perceptojnë skemat e granteve dhe subvencioneve si jo transparente, burokratike dhe që shpesh favorizojnë aplikantë me lidhje politike apo personale, në vend të propozimeve cilësore.

"Shumë grante ndonjëherë merren nga njerëz pranë pushtetit. Është turp dhe e dhimbshme të shohësh të rinj me ide të qarta dhe novatore, të cilëve aplikimet as nuk ju lexohen."

3

Akresi i kufizuar në informacion, njohuri dhe asistencë teknike u përshkrua si një pengesë në dukje e fshehur, por e përhapur. Edhe kur mundësi, grante apo programe ekzistojnë, shumë të rinj në zonat rurale nuk janë të informuar mbi këto mundësi, informohen shumë vonë ose nuk kanë njohuritë e duhura për të aplikuar.

Informacioni është shpesh i fragmentuar, procedurat janë të ndërlikuara, dhe nuk ka asnjë mekanizëm të qartë që t'i udhëheqë të rinjtë nga ideja deri në zbatim. Ata përshkruan një hendek të vazhdueshëm ku ambicia dhe idetë nuk mungojnë, por mungojnë njohuritë praktike se si të hartohet një plan biznesi, si të kalohen procedurat burokratike apo si të përfitohet këshillim teknik mbi bujqësinë.

"Idetë mbeten të parealizuara për shkak të mungesës së njohurive praktike, të arsimit të duhur, të mënyrës si vihet në praktikë një ide. Duhet më shumë fokus në trajnime që synojnë posaçërisht të rinjtë rural."

Mungesa e jetës sociale dhe e mundësive për zhvillim personal u përshkrua nga shumë të rinj si një aspekt që fshin ndjenjën e tyre të përkatësisë dhe motivimin afatgjatë për të qëndruar në komunitetet e tyre.

Ata përshkruajnë fshatra pa qendra rinore, pa hapësira kulturore, pa ambiente sportive dhe aktivitete sociale apo kulturore. Disa e lidhën këtë drejtpërdrejt me shëndetin mendor dhe mirëqenien, duke përshkruar një ndjenjë stanjacioni dhe izolimi që përkeqëson vështirësitë ekonomike.

Përfshirja e kufizuar në proceset vendimmarrëse mund të konsiderohet si një arsye strukturore pse sfidat e tjera vazhdojnë të mbeten të paadresuara vit pas viti.

Të rinjtë në zonat rurale ndihen të padukshëm para institucioneve publike që duhet t'u shërbejnë. Ata rrallë konsultohen nga qeverisja vendore mbi planet e zhvillimit, buxhetet apo prioritetet e shërbimeve. Në këtë kuadër, të rinjtë theksuan se këshillat vendorë dominohen nga grupmosha më të vjetra, me pak ose aspak mekanizma formalë përmes të cilëve mendimet e të rinjve mblidhen apo merren parasysh në mënyrë sistematike. Aty ku konsultimet ndodhin, të rinjtë i perceptojnë ato si simbolike, procedura formale të shkëputura nga rezultatet aktuale të politikave.

Për më tepër, perceptohet një meritokraci e kufizuar në punësim dhe shpërndarjen e granteve, si dhe procese burokratike që dekurajojnë në vend që të mundësojnë nismat e udhëhequra nga të rinjtë. Gjithashtu, ekziston një ndjenjë e përgjithshme se vendimet mbi zhvillimin rural merren për të rinjtë dhe me të rinjtë. Kjo u parashtrua jo si kërkesë për përfaqësim simbolik, por si thirrje për ndryshim strukturor.

“Na përfshini, ne duam të jemi në tryezë jo vetëm si pjesëmarrës, por si i japin formë agjendave ku diskutohet për politikën e zhvillimit rural dhe të rinjtë.”

Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme vijnë si rezultat i drejtpërdrejtë i konsultimit me të rinjtë nga zonat rurale, të cilët kërkojnë:

1. Të sigurohen shërbimet thelbësore dhe infrastruktura bazike për të rinjtë nga zonat rurale si, infrastruktura rrugore, transporti publik, kujdesi shëndetësor, arsimi dhe qasja në internet, si parakushte për mundësi të barabarta.
2. Ne mbështesim prezantimin e skemës mbështetëse dedikuar për të rinjtë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, por kërkojmë mbështetje të vazhdueshme financiare: grante të vogla fillestare që mbulojnë kostot bazë të nisjes, kredi pa interes ose me interes të ulët të garantuara nga shteti, procedura aplikimi të thjeshtuara, dhe mbështetje mentorimi gjatë zbatimit, jo vetëm në fazën e financimit.
3. Të sigurohet transparencë në shpërndarjen e fondeve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, për të garantuar llogaridhënien dhe shpërndarjen e drejtë të burimeve.
4. Të sigurohet akses në informacion, mentorim dhe asistencë teknike, përmes krijimit dhe mbështetjes së qendrave të këshillimit në nivel vendor, si Qendrat e Asistencës Bujqësore dhe

Rurale (QABR), me profesionistë të rinj të kualifikuar që ofrojnë në mënyrë proaktive informacion mbi mundësitë e financimit, procedurat e aplikimit dhe udhëzimet teknike.

5. Sigurimi i jetës sociale, kulturore dhe komunitare në zonat rurale është domosdoshmëri për të nxitur të rinjtë në zonat rurale të qëndrojnë dhe investojnë në zonat rurale, përmes financimit dhe mbajtjes funksionale të qendrave rinore aktive gjatë gjithë vitit, programeve të vazhdueshme kulturore dhe sportive, të dizajnuara posaçërisht për të rinjtë rural.
6. Të sigurohet përfshirja e njëmëndtë e të rinjve nga zonat rurale në proceset e vendimmarrjes, duke krijuar mekanizma formalë përmes të cilëve të rinjtë konsultohen në mënyrë sistematike mbi planet e zhvillimit vendor, hartimin e buxheteve dhe marrjen në konsideratë të nevojave dhe prioritetëve të tyre.
7. Të sigurohet që strategjia e ardhshme kombëtare e Shqipërisë për bujqësinë dhe zhvillimin rural t'i vendosë në mënyrë të drejtpërdrejtë të rinjtë në qendër të saj. Në praktikë, kjo duhet të përkthehet në angazhime konkrete përmes objektivave të qartë për mbajtjen e të rinjve në zonat rurale, dhe një mekanizëm formal për pjesëmarrjen e vazhdueshme të të rinjve rural në zbatimin e strategjisë.

Të rinjtë që morën pjesë në këtë konsultim nuk kërkuan bamirësi. Ata kërkuan kushte të barabarta, infrastrukturë bazë, akses në financim, trajnime, informacion dhe përfshirje, për të plotësuar parakushtet e nevojshme për të ndërtuar të ardhmen në vendin që e quajnë “shtëpi”. Ata kërkojnë të konsiderohen jo si përfitues pasivë, por si partnerë strategjikë në formësimin e të ardhmes së komuniteteve rurale.

E drejta për të qëndruar nuk duhet të mbetet vetëm një parim politik, por të përkthehet në investime, shërbime cilësore dhe pjesëmarrje reale të të rinjve në vendimmarrje. Vetëm kështu Shqipëria mund të ndërtojë komunitete rurale të gjalla dhe të qëndrueshme.